



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:243803

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07020733

PKR.nr.168/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Xhemajl JUSUFI, me praktikanten Ellmeka Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.H., për shkak të veprave penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*) dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.279/2021, të datës 26.09.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 14.03.2025, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Sahit Tmava, të pandehurit B.H. si dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit, avokat Gani Rexha, me datë 17.03.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

B.H., nga i ati B., e ëma F., e gjinisë K., i lindur me datë ..., në Mitrovicë, tani me vendbanim në Rr. "Elvia Qelebia", Llamella 3 nr.21 kati 2, me vendqëndrim në Gjermani, me numër personal të identifikimit ....., ka të kryer shkollën fillore, punon në firmën "A.B." si punëtor i ndërtimitarisë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

I

Me datë 30.10.2021 rreth orës 22:30 minuta në rrugën "Elvia Qelebia" në Mitrovicë, saktësisht në ndërtesën "Llamella 3"- ndërtesë kolektive, pa autorizim ka poseduar me qëllim shitje substanca narkotike të shpallura me ligj si narkotikë, ashtu që policia e Kosovës Sektori i hetimeve rajonale jugu në Mitrovicë derisa ka qenë në zbatim të një urdhër-kontrolli në hyrjen kësaj ndërtese është

gjetur një peshore digjitale “Constant”, dy qese najloni me substancë narkotike, njëra në peshë prej 28.3 gram, dhe tjetra në peshë prej 49.7 gram dhe 11 paketime të vogla me substancë të dyshuar narkotike në peshë prej 11.3 gram, të cilat pas ekzaminimit rrjedh se përmbajnë Kanabis (Mariuhanë) në peshë neto 79.37+-0.0001 gram, pronë e të pandehurit, të cilat i janë konfiskuar nga ana e policisë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

## II

Prej datës së përcaktuar e gjer më datë 30.10.2021 rreth orës 22:30 minuta, në rrugën “Elvia Qelebia” në Mitrovicë, ka poseduar armë në shkelje me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në hyrjen e ndërtesës “Llamella 3”, në çatinë e kësaj ndërtese, është gjetur një armë “AK-47” me numër serik .... dhe tre karikator si dhe 17 fishek, pronë e të pandehurit, e cila është konfiskuar nga ana e policisë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata, në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 79, 267 paragrafi 1 dhe 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe neneve 242, 276, 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së, të akuzuarit i:

## C A K T O N

-Për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas pikës një (I) të dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej një mijë (1,000.00) euro.

-Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas pikës dy (II) të dispozitivit, dënim me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) euro.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit B.H. i:

## S H Q I P T O N

- I. Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në dënimin e shqiptuar, të pandehurit i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 30.10.2021 e deri me datë 21.12.2021 dhe në arrest shtëpiak nga data 21.12.2021 e deri me datë 21.01.2022.
- II. Dënim unik me gjobë në shumë prej 1,600.00 euro (*me fjalë: një mijë e gjashtëqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.
- III. Në mbështetje të nenit 267 paragrafi 5 dhe nenin 366 paragrafi 3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.4 të KPP-së, të pandehurit i konfiskohen sendet dhe atë:
  - Substanca narkotike e llojit kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC), në peshë neto prej 79.37+- 0.0001 gram.
  - Një (1) pushkë automatike "AK 47", me numër serik ....
  - Tre (3) karikator
  - Shtatëmbëdhjetë (17) fishek.

Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, sasia e narkotikut, bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, ndërsa armët të shkatërrohen nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pasi të vërtetohet se armët nuk janë përdorur në ndonjë rast tjetër penal nga Libri i Rasteve të Hapura.
- IV. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50), të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur Aktakuzën PP.I.nr.279/2021 e datës 26.09.2023 kundër të pandehurit B.H., për shkak të veprave penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike ose analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 14.03.2025, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i shtetit Sahit Tmava, i pandehuri B.H., si dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokati Gani Rexha.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe ka deklaruar se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë. Ndërsa sa i përket sanksionit penal, ka mbështetur fjalën e mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se është penduar shumë për rastin që ka ndodhur, se ka ndërtuar një jetë të re në Gjermani dhe ka premtuar se kurrë më nuk do të përsëris kryerjen e veprave penale.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar gjykatës të bëhet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i njëjti është këshilluar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe është njoftuar nga gjykata për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë. Ndërsa sa i përket sanksionit penal, i ka propozuar gjykatës të merr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara me ligj, mirëpo pranimin e fajësisë posaçërisht ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit B.H., avokat Gani Rexha, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: i propozon gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë, pasi që e njëjta është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës. Sa i përket sanksionit penal, ka deklaruar se gjykata duhet të marr parasysh faktet se i pandehuri është i moshës së re, i pagjykuar më parë, i njëjti është punësuar në botën e jashtme ku edhe jeton me familje, është penduar thellësisht për kryerjen e këtyre veprave penale.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: raportet policore sipas numrit të rastit me nr. 2021-BI-64 të dt.01.09.2021, vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.31.10.2021, listat e dëshmimeve e dt.30.10.2021, urdhrin për aprovim retroaktiv të urdhrin për kontroll të dt.31.10.2021, raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes të dt.30.10.2021, raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2021-3457/2021-3330 i dt.14.09.2022, raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për forenzikë AKF/2021-3457/2021-3331 i dt.22.09.2022, foto-dokumentacionet si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimi të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprat penale që i vihen në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të njëjtit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e pandehura.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i njëjti, me veprimet e tij, ka kryer veprat penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së për të cilën veprë është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vite dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën veprë, është paraparë dënim me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7,500) euro ose me burgim deri në pesë vite.

#### *Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata si rrethanë rënduese, gjeti dashjen e lartë të kryerësit të veprës penale për kryerjen e veprave penale, rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale, në kontekst të asaj se kjo natyrë e veprave penale

është gjithnjë në rritje në vendin tonë si dhe faktin se e pandehuri edhe më parë ka qenë i gjykuar me vendim të formës së prerë dhe atë në dy raste të tjera, për veprat penale kanosja dhe veprën penale vrasje në tentativë.

Ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari, kërkim faljen për veprën të cilën e ka kryer, pendimin e sinqertë të shprehur nga i pandehuri në seancë, moshën e re, rrethanat personale e familjare marrë parasysh faktin se i njëjti është tashmë është duke jetuar dhe punuar në Gjermani, ku edhe është i punësuar dhe jeton atje.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit për të pandehurin sa i përket veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për zbutjen e dënimit në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, janë plotësuar kushtet për shqiptim të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim efektiv dhe me gjobë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen e pandehura të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

#### *Vendimi për llogaritjen e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar*

Gjykata, në dënimin me burgim të shqiptuar për të pandehurin, ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak, bazuar në dispozitën e nenit 79 të KPRK-së.

#### *Vendimi për konfiskim*

Gjykata, vendimin si në pikën III të dispozitivit për konfiskimin e substancës narkotike dhe armëve të gjetura te i pandehuri, e mori duke u mbështetur në nenin 267 paragrafi 5 dhe nenin 366 paragrafi 3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.4 të KPP-së.

*Vendimi për shpenzimet e procedurës penale:*

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

*Kërkesa pasurore juridike:*

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata nuk ka vendosur pasi që nuk kishte palë të dëmtuar të propozuar në aktakuzë.

Andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 242, 276, 364, 449, 450, dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.168/2023, datë 20.03.2025

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari:  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.